



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog  
Skupština Opštine Istok  
Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

31	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	18.11.2020, në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
<b>Procesmbajtës:</b>	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lart për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Arditë Idrizaj
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjerë:</b>	Kryetari i Komunës, z. Haki Rugova, Drejtorat: Hysni Maxharraj, Hazbi Bajraj, Mujë Osmanaj, Drin Sadikaj, Lulzim Blakaj, Demë Qeta, Osmon Sadikaj, Zyrtar Administrativ: Zekije Sutaj, Flora Bujupaj, Fjollë Berisha.
<b>Rendi i ditës:</b> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Konstatimi i prezencës së anëtareve të Komitetit,</li><li>2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara ( të datës: 23.09.2020 dhe 28.09.2020) ,</li><li>3. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator)të vitit fiskal 2020,</li><li>4. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2021</li><li>5. Shpallja në Diskutim Publike e Draft - Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba,</li><li>6. Shpallja në Diskutim Publike e Draft - Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës,</li><li>7. Marrja e Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të ngastrës kadastrale Nr.01776-2 Zona Kadastrale Istog.</li><li>8. Shqyrtimi i kërkesës 08Nr.316/2020 të datës 02.11.2020 nga Drejtorati për Shërbime Publike .</li></ol>	
<b>Diskutimet:</b>	
Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Salla që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjera	

janë pajisur me maska, doreza dhe dezinfektues në tavolina.

Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Prezanton rendin e ditës,

Fton Ekzekutivin si dhe Anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?

Përhëndet Kryetarin e Komunës që po sa arriti në sallë.

Së pari kam një propozim unë për pikë të rendit të ditës të cilën materiali është përgatitur me vonesë , sot na ka mbërritur një kërkesë inicuese e cila i është drejtuar kryetarit të komunës edhe mua si kryesues, ka të bëjë me anulimin e disa vendimeve, pesë vendime të cilat i kemi marr në kuvend të komunës për shpalljen në ankand publik të pesë zonave kadastrale për dhënien në shfrytëzim afat shkurtër deri në 15 vite. Procedurat për dhënien e këtyre pronave kanë përfunduar nga ekzekutivi dhe nga kuvendi por me shpalljen e ankandit dhe komisioni vlerësues në takim që ka pasur pas mbylljes së ankandit publik ka konstatuar se nuk ka pasur ofertues të mjaftueshme për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave komunale ka ndryshuar kemi ligjin dhe Rregulloren e cila është e bazuar në ligj për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës. Pasi që ato vendime kanë mbetur të pa zbatueshme është një kërkesë inicuese nga drejtorati përkatës i Bujqësisë dhe nga zyrtari ligjor për prona që të anulohen këto pesë vendime. Propozoj që të merret si pikë e rendit të ditës.

Hedh në miratim

Miratohet një zëri, që ky propozim të hy si pikë e rendit të ditës .

Fjalën ja kalon znj. Ajshe Metaj.

**Ajshe Metaj** – përhëndet të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë të shtohet si pikë e rendit të ditës lidhur me emërtimin e Palestrës së Sporteve në Istog. Propozoj që palestra të marrë emrin e ish anëtarit të Kuvendit z. Labinot Aliaj, për shkak që është rritur në sport ka kërkuar për sport, mendoj që është propozim sa has në përkrahje nuk e di, ky është propozim i imi me e fut në rend të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj**, - e nderuar anëtare e komitetit lidhur me këtë pikë mendoj që është dashur që paraprakisht pak edhe të konsultohemi me këtë propozim, është e drejt e juaja të propozoni. Ne ndjejmë dhimbje dhe pikëllim atë e kemi shprehur edhe në mbledhjen komemorative për humbjen e Labinotit, çdo nder për punë jetën de tije djalë i ri por lidhur me këtë që po potenconi ju këtu për emërtimet është një ligj dhe janë bukur do procedura të cilat duhet të tejkalohej dej të vihet kjo çështje, prandaj mendoj që edhe KPF-ja në këtë moment po edhe ekzekutive është i pa përgatitur që të diskutojmë lidhur me këtë mbetet kjo për me vonë për herët tjera, mendoj që kjo duhet të iniciohet me ndryshe jo në këtë formë, për ndryshe unë vetëm këtë nuk mund ta mohoj lidhur me këtë, edhe dikush tjetër të diskutoj këtë çështje, po mendoj që nuk është koha ta vëmë si pikë të rendit të ditës në këtë moment në komitet pra këtu jemi mund të bisedojmë.

**Ajshe Metaj** - unë nuk thash me vendos këtu vetë shprehja që nëse hasi përkrahje që kjo pikë me kaluar përmes KPF-së, nëse nuk janë votat asgjë askujt. Mbesim ashtu siç kemi qenë, ky ke propozim i imi, ndoshta nuk kamë ber gabim që kam kërkuar diçka nëse është e drejt dhe mundet me u hedh në votim, kjo ka procedura nuk donë me thënë që me u hedh menjëherë në votim mbledhjen e ardhshme po mund ti filtroni sendet ashtu siç ju mendoni unë mendoj që kam drejtë

me propozuar edhe duhet me fut në votim nëse kalon si pikë e rendit të ditës nëse kalon mirë që jo mbesim këtu ku jemi.

**Zenel Shatri** - përshëndet të gjithë të pranishmit, profesorësh na vure në një lajthitje shumë të madhe ne na u ka dhimbsur shumë Labinoti të gjithëve, nuk e besoj që veç neve por të gjithëve dhe ne masë shumti por ndoshta ky adresim ky për emrimin nuk është vendi i duhur nuk e di lidhshmëritë nuk jam as një kundër por po na qet në lajthitje me votimet nëse është rendi dhe ligjërish duhet të iniciohet nga KPF-ja çka unë ligjin nuk e di mirë nëse është dikush këtu me ligje që din ne nuk jemi kundër fare por mu me duket që duhet me procedura të tjera jemi për ska pikë problemi por jemi në lajthitje sepse nëse nuk është të iniciohet nga këtu besoj që nuk kemi nevoj të diskutojmë për këtë punë.

**Haki Podrimaj** - përshëndet të gjithë të pranishmit, e përkrah doktorin se nuk është momenti me u merr tani me këtë raste sepse ne kemi pasur dhimbje të gjithë për Labinotin se ka vdekur një djalë i ri një koleg i jonë një punëtor i madh një punëtor me elan për punë, Ajshja e potencoj profesoresha edhe ne tjerët që jemi këtu kemi emra me propozuar për dikë, por nuk është koha as momenti që ne me u merr me atë çështje, bile bile me emrin e Labinotit nuk është momenti sepse të gjithë ne këtu dhe familjaret e tij kanë dhembje, dhe po na qet në lajthitje në këtë Kuvend a me e votu a mos me e votu. Kështu që nuk ma merr mendja që nuk është koha dhe kisha kërkuar nga kolegja që të tërhiqet me këtë propozim vijnë ditë tjera që merremi me emra po edhe emra tjerë që kanë jep për sport, që kanë dhënë jetën për liri, ka emra tjerë që ne nuk i kemi potencuar nuk kemi jep emra dhe nuk jam për me jep emra. Prandaj edhe një here e kisha lutur kolegen që të heq këtë propozim dhe në ditët e ardhshme të ulemi dhe të diskutojmë për këtë.

**Eliot Kukiqi** - përshëndet të gjithë të pranishmit, unë përkrahi propozimin e Ajshes nëse vjen puna të votimi.

**Ajshe Metaj** - Faleminderit nga kolegët që po me tregojnë kur është rendi dhe kur nuk është, në fakt palestra ka përfunduar dhe kërkon një emërtim unë nuk kesh një fakturë që vendosa që me ja vendosë këtë emër është propozim i jem kërkush nuk me ka thanë asgjë e kam pa të arsyeshme me propozu askush askën nuk e ndal me propozuar le të propozon gjethkush emrin që e ka preferencë prandaj nuk kam nevojë me tërheqë se tërheqi hiç si kalon si nuk kalon u kry kjo punë.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj** - Nuk është ashtu çështja ashtu si kalon si mos kalon, mendojë se është shprehje e gabuar e juaj mendoj që nuk jemi të gatshëm në mënyrën ligjore të përgatitjes të procedurave për emërim, kështu që propozojë që kjo të mbetet për ma vonë të shohim edhe aspektin ligjor dhe aktet normative ligjore si vijnë propozimet si mbahen ato dhe formojmë dhe nuk është fjala veç për palestrën që duhet te emërohet të dimë që kemi edhe rrugë tjera që janë të pa emëruar, dhe kemi rrugë të reja që janë ndërtuar ma vonë pas përfundimit të emërtimit të tyre kemi dhe objektet, tjera institucionale ndoshta që ka nevojë unë mendoj që nuk është mirë të hapim këtë rast, një temë të tillë të pa përgatitur, dhe do vjen koha dhe do merrem me atë punë është vërtete që është kompetencë e Kuvendit, emërtimi i rrugëve dhe shesheve dhe gjithë atyre por ato duhet të vinë të përgatitur duke bazuar në aktet ligjore dhe normative nga Drejtoritë apo zyrtaret përkatës që kanë të bëjnë lidhur me këtë lami faktikisht me sa di më emërtimet që i kemi pasur ma përpara prapë nuk jam i gatshëm këtë diskutim si duhet por duhet në një lloj forme

me krijua një formë bashkërisht, nuk është ka mophon po duhet të përgatiten për këtë e di që për këto emërime, bahen edhe debate dhe janë bërë debate dhe me emërimin rrugëve dhe objekteve të ndryshme është ligji që procedon dhe nuk jam i përgatitur për këtë punë dhe e kisha marr ligjin me vete, dhe i kisha ftuar zyrtarët ligjor, na e kemi zyrtaren ligjore po e konsideroj se nuk është e përgatitur në këtë moment prandaj propozoj për këtë të shtyhet propozimi i Ajshes dhe të shohim ma vonë, a pajtoheni edhe ju qe ky pikë e rendit ditës propozoj qe Ajshja le të mbetet në të ardhmen për ma vonë pyes,anëtarët e komunitetit për Politikë dhe Financa mbetet për më vonë nuk mund të fusim si pikë të rendit të ditës të përgatitjes se çka do bëjmë me këtë të marrim të lajm për ma vonë.

**Kryetari i Komunës z Haki Rugova** - Nuk keni nevojë me nxit një diçka se këtu tash çdo propozim qe e fut në votim automatikisht krijojnë ka me dal opiniononi qe dikush është për dhe dikush është kundër, dhe nuk është askush kundër mirëpo ka të drejtë Qaushi plotësisht aty hala nuk janë kryer punimet dhe kur kryhen punimet aty ka mu marr një emër edhe ajo procedura për emërimin e objekteve të karakterit të tij. Çfarëdo objekti publik që është e ka një procedurë që asnjëri nga ne nuk e dimë. Dhimbja e Labit ka qenë e madhe për të gjithë ne, dhe nuk po kam dëshirë të ju hy atyre ndjenjave, ju e dini unë vet jam kundërshtuar me Labin mirë po e kam pasur simpatik tërë jetën po tregoj drejtë. Mos na qitni në pozita si subjekte politike që ne jemi kundër Labit e ju jeni pro nuk është mirë ajo. Për ta dërguar këtë pikë të rendit të ditës në kuvend duhet ti shikojmë edhe disa gjera, nuk mund të thuhet palestrës së sportit në Istog i ngjitet emri Labinot Alijaj.

**Eliot Kukiqi** - ta votojmë që të jetë si pikë e rendit të ditës si diskutim me KK.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj** - për këtë temë duhet me pas edhe bazë ligjore.

**Zenel Shatri** - po e them atë që unë jam duke e ndjerë, me ka ra me pa çfarëdo raste të rënda dhe jam njeri i durueshëm po në këtë moment shikoni jam duke u dridhur i tëri po e shohë edhe kolegen në të njëjtën gjendje na keni vënë në lajthitje. Ende nuk ka përfunduar e pamja e ne po diskutojmë për të, Ajshen e kuptoj që i ka pasur edhe do problem përpara, nuk e di nuk po rezunojmë me trunin tonë ju. Edhe ju kryesues unë besoj që nuk duhet diskutohet fare për të po dridhem bre nuk ma merr menja qe ju ka dhimtë, nuk po them që mu ka dhimtë me së shumti po me të vërtet jam duke u dridhur me bisedu me njërin se sa ka vdekur, nuk jam kundër emrit e nuk jam kundër asgjëje por ka kohë me bisedu. Nuk e di a kemi ndjenja njerëzore ne për atë njeri ose për krejt me ja lkund eshtrat ne sot me bisedu për të po kjo është marrja e zotit për mendimin tim me falni të gjithi që po flas me emocione por jam shumë shumë i shqetësuar për një djalë 28 vjeçar me bisedu a me ja dhënë e mos me ja dhenë nuk e di ku po e merrni ju të gjithë atë fuqi. Kryesues mos na qitni në lajthitje shtynë këtë pikë për ndonjë mbledhje tjetër jo tani. Me falni që po flas me emocione por me të vërtet me u ka dhimbsur ai djalë 28 vjeçar e kamë përjetuar shumë keq dhe tani me fol për të mu po me duket shumë e pa arsyeshme kështu që mos na qitni në lajthitje.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj** - ju lutem të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës të cilat janë të parapara. Fjalën ja kalon Ajshë Metaj.

**Ajshë Metaj** - është vendim i juaji i të gjithëve unë nuk muj me vendos asgjë le të shtyhet ky propozim, vetëm se unë këtu nuk shohë kurrfarë marrje, me fal koleg por unë nuk po shohë këtu diçka që kam bërë marre.

**Zenel Shatri** – shiko profesorëshë marre nuk keni bërë, vetëm se të diskutohet ky propozim kurë të jemi me të qetë sepse tani jemi shumë të prekur nga rasti.

**Mujë Osmanaj, Drejtor i Shëndetësisë** – përshëndet të gjithë të pranishmit, me falni por kjo temë debatohet shumë qetë, askush nuk po mendon diçka që me nxerr ose me qitë Ajshen në këtë pozitë, unë tash po e shohë Ajshen as që kemi komunikuar as asgjë, por që tha Kryetari rrjetet sociale e të gjitha sot aty prej do të rinjve nga Istogu është dhënë një iniciativë e tillë që Labi fillimisht si sportist si me të gjitha ato kërkesa që i ka paraqitur për sportin dhe të rinjtë e Istogut. E dyta ka pasur shumë djem të ri që na u kanë dhimsur këtu nga Istogu nga qendra.

Këtu të rinjtë kanë filluar këtë iniciativë si një lloje peticioni me mbledhjen e nënshkrimeve, nuk e di a ka biseduar dikush nga ta me Kryetarin por është një çështje që Labi ka qenë asambleist, të bisedohet vijnë ato nënshkrime e dikush ka me e kërkuar edhe brenda seancës por mirë kishte qenë që të bisedohet me qetë, se të sillet në seancë gjithqysh ka me u kërkuar edhe me ardhë të një polarizim pa nevojë. Singërisht emri i Labit po i la raportet e mija me të po në bazë të rrjeteve sociale të gjithë i lidh një vend se ka prej tyre, familjar të dëshmoreve që po bëjnë nomin atje.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj** – doktor të shpjegova procedurën jemi të pa gatshëm është një Ligj një Rregullore e procedurave të emërimeve e që për momentin jemi të pa gatshëm në këtë kohë.

**Mujë Osmanaj, Drejtor i Shëndetësisë** – sigurisht edhe këto duhet me u involvuar edhe Lul Shoshi edhe Drejtorati i Kulturës.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj** – janë disa procedura dhe rregulla që duhet ti zbatojmë dhe ti përmbahemi.

**Kryetari i Komunës z. Haki Rugova** – çka ta merr mendja ty që ka njeri këtu që ka propozime dhe organizohet ndonjë peticion tjetër që ja mund këtij dhe e harroni këtë pse po e boni këtë ja ngjisim emrin Palestra Istogu' edhe përfundon, kur duhet me marr vendime të rëndësishme e vendime ligjore duhet me i harru edhe emocionet. Ju lutem mos të bëjmi gara mes vetes se kush është me i mërzhitur dhe kush ka emocione me shumë nuk është e mirë kjo unë nuk jam kundër me ja vendos emrin e Labit por do të kemi probleme sepse del tjetri e tjetri e plot emra të tjerë edhe që po përmenden, është përmendur edhe shtëpia e kulturës ne kemi plot dëshmor të Istogut.

Shqyrtimi i peticioneve çfarëdo peticioni e ka mënyrën e vet të shqyrtimit ligjor janë disa procedura i kemi edhe këtu zyrtaret ligjor dhe juristat, ne kemi pasur peticione edhe përpara, nuk kanë mundur me u realizu për shkak të procedurave ligjore. Që peticionin për Labionot Alijaj me ma pru mu dikush e nënshkruaj. Ajshë të kuptoj shumë mirë por nuk bën kështu janë disa procedura.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj** – po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës besoj që i keni përpara. Me një pikë shtesë që e përmenda në fillim

**Kush është që të miratohet rendi i ditës me këto pika.**

**Miratohet rendi i ditës me shumicë votash**

**4 për, 2 abstenime dhe 1 votë kundër**

Prezent në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komitetit

<b>Vendimet:</b>	
Miratohet me shumicë votash rendi i ditës, me këtë propozim nga Ekzekutivi.	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 1.</b>	
<b>Diskutimet:</b>	
Kryesuesi – Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit, konstatoj që të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa janë prezentë në këtë mbledhje, dhe mund të fillojmë me pikat në vazhdim.	
<b>Vendimet:</b>	
Vazhdojmë me mbledhjen	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 2.</b>	
<b>Diskutimet:</b>	
Kryesuesi, vazhdojmë më pikën tjetër të rendit të ditës: Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. a ka dikush diçka. Pasi që diskutime nuk pat hedh në miratim. Miratohen një zëri procesverbalet nga mbledhjet e kaluara Të gjithë anëtarët e Komitetit prezent.	
<b>Vendimet:</b>	
Miratohen njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 3.</b>	
<b>Diskutimet:</b>	
Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator) të vitit fiskal 2020, fjalën ja kalon Zyrtarit Kryesor Financiar z. Osmon Sadikaj.	
Osmon Sadikaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator) të vitit fiskal 2020.	
Eliot Kukiqi – vetë deshta ta pyes drejtorin se të shpenzimet kapitale sa përqind kanë të shpenzuara deri në këtë gjashtëmujorësh. Për projekte kapitale.	
Osmon Sadikaj – i kemi sipas burimeve të financimit të shpenzuara mbi 6 milion kanë qenë ndarje buxhetore të alokuara po ashtu mbi 6 milion euro të shpenzuara mbi 3 milionë kjo shumë është pra	

2 milion e gjysme të huas për ujësjellësin ndërsa pjesët tjera janë të inkorporuara bashke me këtë. Jemi në vrullin me të madh të shpenzimit po shpresojmë që TM4 do të jetë me i mirë se ky.

**Kryesuesi**, atëherë dihet që kjo pikë duhet të jetë edhe në kuvend, do të debatojmë edhe aty. Unë pyes anëtarët e Komitetit a pajtoheni që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, besoj që të gjithë jeni për atë.

Në mënyrë unanime anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa ja përcjellin Kuvendit për shqyrtim, Raportin Financiar për 3 mujorin e tretë të këtij viti kalendarik.

**Vendimet:**

**Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyrë unanime: raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator) të vitit fiskal 2020, ia kalohet KK-së për shqyrtim.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 4.**

**Kryesuesi**, vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2021.

Të nderuar anëtarë të Komitetit, jemi në prag të përfundimit të këtij viti kalendarik, besoj që veç jeni në dijeni që në çdo prag të përfundimit të vitit Kuvendi debaton edhe Raportin e punës gjatë vitit por në të njëjtën kohë edhe përgatitet për vitin tjetër kalendarik me Planin e punës. Që të hartojmë Planin e punës të Kuvendit për vitin e ardhshëm, është e nevojshme të formojmë komision, e kemi formuar edhe në vitet paraprake që ka hartuar Planin e punës, nuk do të lëshohemi në këto çështjet tjera, çelësi është të kemi nga të gjitha partitë politike përfaqësues në Kuvend, partitë më të mëdha të kemi nga një anëtar, kështu kemi pasur edhe vitin e kaluar. Kemi pasur nga një anëtar nga LDK-ja, nga PDK-ja, AAK-ja, nga VV-ja dhe një nga komuniteti pakicë. D.m.th gjithsej i kemi pasur 5 (pesë) anëtarë të komisionit, edhe unë si kryesues i Kuvendit. Kështu që unë mendoj që veç të ja përcjellim si pikë të rendit të ditës Kuvendit, e në Kuvend t'i bëjmë propozimet e që edhe subjektet politike përgatiten propozimin edhe të formojmë komisionin e pastaj të shohim për oraret e takimeve. Kush është që kjo pikë e rendit të ditës t'i përcillet Kuvendit me këtë formulim për shqyrtim dhe miratim. Kush është për?

Në mënyrë unanime konstatojmë që Komiteti për Politikë dhe Financa ja përcjellë Kuvendit Komunal këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim dhe miratim, Formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal.

**Diskutimet:**

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2021. si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

## Shqyrtimi i pikës 5.

### Diskutimet:

**Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj**, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Shpallja në Diskutim Publike e Draft - Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba.

Jeni në dijeni edhe për këtë, që çdo fillim viti është e nevojshme që Kuvendit të miratoj këtë Rregullore, është një Rregullore që hartohet vetëm për një vit, ekzekutivi i komunës ka formuar komisionin për hartimin e kësaj Draft-Rregulloreje normalisht që janë disa përmirësime, dhe e ka sjellë si Draft këtu tek ne, ta përcjellim për Kuvend, dhe të merret vendimi për Shpallje në diskutim publik. Unë nëse nuk ju duket e tepërt, këtu afër e kemi edhe pikën tjetër të rendit të ditës, Rregullorja për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale. Shikoni këto dy Rregullore shkojnë bashkërisht të ngjitura. Lidhur me këtë unë ja kisha përcjell fjalën kryetarit.

**Kryetari i Komunës z. Haki Rugova**, je duke folur për Shpalljen në diskutim për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme.

**Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj** së pari fola për Rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba. Na e shtjellon Hysi nëse ka diçka me shtuar për të dyja më mirë, dhe vendosim për me e përcjell në Kuvend.

**Hysni Maxharraj**, këto çka janë në Draft-Rregullore duhet të inkorporohen në Rregulloren për taksa. D.m.th këto dyja duhet të shkojnë krahas.

**Zenel Shatri**, puna e këtij Komiteti, është që të ja jap vizën me shkuar në diskutim publik, pastaj me jap vërejtje.

**Kryesuesi**, mirë dr.Zenel, ju lutem, është pak mirë me menduar, ne duhet t'i rekomandojmë Kuvendit për shpallje në diskutim publik. Dhe unë duhet të ju pyes ju. A jeni që t'i rekomandohet Kuvendit, ju mund të thoni pastaj që keni diçka për këtë ja u dhashë fjalën, që nuk keni asgjë, kush është që t'i rekomandohet Kuvendit për Shpallje në Diskutim Publik Rregullorja komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba?

Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa që janë prezentë (pesë) 5 që jemi këtu, janë për që t'i rekomandohet Kuvendit për shpallje në diskutim publik të Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba.

**Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.**

### Vendimet:

**Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, KPF unanim rekomandon: Shpallja në Diskutim Publike e Draft - Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba, dhe të njëjtin ia kalohet KK për shqyrtim.**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës , Shpallja në Diskutim Publike e Draft – Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës.

Pra konstatojmë që Komiteti i rekomandon Kuvendit që të shpallë në diskutim publik Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës.

#### Diskutimet:

#### Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon: Shpallja në Diskutim Publike e Draft – Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës. si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës , Marrja e Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të ngastrës kadastrale Nr.01776-2 Zona Kadastrale Istog.

Lidhur me këtë të nderuar anëtarë të Komitetit, drejtori i drejtoratit pak më parë na solli një shkresë, e keni para vetes, besoj që e ka edhe kryetari. Urdhëro kryetar nëse ke diçka.

**Kryetari i Komunës**, unë shkoj me një detyrë tjetër pasi e mora përsiper unë pak me ju jap sqarime. Ju e dini që aty janë duke u implementuar dy projekte rruga “Rina” “Nënë Tereza” do të bëhet edhe rrethi aty te pika e karburnatit, tash e ka “Ibos” në shfrytëzim, do të bëhet një rreth i bukur, mirëpo ajo ajo pompë e benzinës nuk ka vend aty, edhe ka qenë interes i para shumë kohësh që të hiqet ajo, por nuk kishim nevojë me e heq sepse ishte edhe çerdhja e fëmijëve, por ja erdhi momenti i duhur me e heq. Ne kemi diskutuar me AKP-në dhe jemi pajtuar që të hymë në procedura të eliminimit të asaj pompe të benzinës, të krijohet një hapësirë publike aty nuk ka nevojë të bëhet diçka tjetër, ndoshta mundet me ju bashkëngjit edhe çerdhes, apo të jetë si hapësirë e tillë. Si do që të jetë, ajo është një moment tjetër, problem urbanistik, por natyrisht që këtu iniciohet procedura. Kuvendi komunal e ka të drejtën ta shpallë zonë të interesit, me ligj dokumentacioni është, përgatitet dërgohet në Kuvend, atëherë fillojnë procedurat tjera bashkë me AKP-në edhe ata që e menaxhojnë në mënyrë se si me e eliminuar. Aty punimet janë duke vazhduar, rrethi do të shkoj deri në cep të asaj pompe kështu që do të pamundësohet puna aty edhe ata veç janë duke e shfrytëzuar tashmë, nuk janë fort të interesuar as me punuar aty, për interesa tjera po e mbajnë për këto lloj konkurrencave ekonomike, kështu që ajo pompë nuk ka vend. Unë mendoj që Kuvendi komunal do të pajtohet me një gjë të tillë, atëherë ne detyrimisht, shërbimi pronësor do të shkoj në bazë të ligjeve aktuale siç ka ndodhë me Radushën me atë pjesën në qendër që nuk kemi shkuar deri sa është marrë vendimi në instanca më të larta. Kaq nuk kam më shumë, tash po mendoj që e keni më të qartë.

**Kryesuesi**, faleminderit kryetar! Dikush nga anëtarët e Komitetit a e dëshiron fjalën lidhur me këtë

pikë? Jo. Atëherë a pajtoheni që kjo pikë e rendit të ditës t'i përcillet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim? Kush është për?

Konstatohet se në mënyrë unanime Komiteti për Politikë dhe Financa, i rekomandon Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim dhe miratim, pra marrja e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të ngastrës kadastrale Nr.01776-2 Zona Kadastrale Istog.

**Diskutimet:**

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon që Marrja e Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të ngastrës kadastrale Nr.01776-2 Zona Kadastrale Istog, si dhe e njëjta i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 8.

**Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës, Shqyrtimi i kërkesës 08Nr.316/2020 të datës 02.11.2020 nga Drejtorati për Shërbime Publike.**

Të nderuar anëtarë të Komitetit e keni pasur në material një kërkesë që më ka ardhur nga drejtori i drejtoratit për Shërbime Publike. Unë kërkoj që kryetari apo drejtori këtë pikë të rendit të ditës ta arsyetoj, ta shtjelloj para anëtarëve të Komitetit.

**Enver Rugova, faleminderit kryesues! Përshëndet të gjithë të pranishmit! Pas ndarjes së mjeteve nga Qeveria e Kosovës 10 milionë euro, për ndihmë dhe rimëkëmbje për komunat e Kosovës. E ka përmendur edhe kryetari në mbledhjen e kaluar të Kuvendit se janë të ndara 264 mijë euro ekzakt. Në drejtorinë e Shërbimeve Publike i kemi 100 mijë euro d.m.th për Covid-19 janë, 40 mijë euro i kemi ndarë për ushqime, 25 mijë euro për dezinfektim dhe 35 mijë euro për subvencionim për Stacionin e Autobusëve që dihet në çfarë gjendje është, edhe Covid-19 i ka dëmtuar mjaft, edhe ato të ardhura çka i kanë pasur i kanë shumë minimale. Unë si kryetari i komisionit të aksionerëve që ma jap pozita e drejtorit të drejtoriatit të Shërbimeve Publike në bisedime edhe me kryetarin jemi konsultuar edhe me drejtorin e Buxhetit, kështu që e kemi paraqitur para jush që si subvencionim të jetë, sepse dallon ajo si ndihmë tjera që i kemi dhënë përpara edhe të jetë si subvencionim d.m.th është në kuadër edhe të Covid-19 nuk shkelet as ligji as një Rregullore për me ja u ndarë këto mjete, pse e kemi fut në Kuvend edhe pse tjerat mjete nuk i kemi fut, por është ajo që po bëjmë një subvencionim ndaj një kompanie publike d.m.th po i ndihmojmë një kompanie publike që është mire, dhe ju si asambleistë edhe si Komitet për Politikë dhe Financa të jeni edhe të informuar por të jeni edhe pjesëmarrës në këtë vendim. Këto të ushqimi dhe dezinfektimi janë kontrata kornizë d.m.th edhe për vitin 2021, aty ka mundësi vitin e ardhshëm me i shtuar ato kontrata sepse ato të mjaftueshme nuk janë, dhashtë Zoti që mos të ketë pandemic edhe përfundon kjo punë por shifrat nuk po na tregojnë të njëjtën. Edhe vitin e ardhshëm mundemi me i rrit shumat të dezinfektimi edhe të ushqimit, d.m.th aty mundemi me pas amplitud e këtu të subvencionimi nuk ka. Ndahet kjo shumë, edhe për ata e kemi sjellë këtu para jush.**

**Osman Sadikaj, nëse me lejohet kryetar dhe kryesues a bën një sqarim këtu?**

Kryesuesi, urdhëro Osman!

Osman Sadikaj, unë e ndjeva të obligueshme sipas pozitës që e kam si zyrtar kryesor financiar jam i obliguar çdoherë që kur ka të bëj me paranë publike që të sqaroj rregullat e menaxhimit të parasë publike. Prandaj ndërhyra, ju e dini e keni marrë edhe një vendim herën e kaluar 35 mijë euro që nuk ka qenë i ligjshëm për me u votuar, e njejtat gjë është tash, nëse është prej pandemisë Covid-19, në bazë të ligjit për ndihmë shtetërore parlamenti i Kosovës ka formuar komisionin për 5 (pesë) anëtarësh që çdo organizatë buxhetore që dëshiron me i ndihmuar ndërmarrjet publike duhet paraprakisht që të dërgoj kërkesën te ky komision që nëse marrin aprovim prej tyre pastaj të vazhdojnë me procedurat tjera.

Kryetari i Komunës, kush e dërgon kërkesën?

Osman Sadikaj, ne duhet me e dërguar komuna.

Kryetari i Komunës, kush jemi ne? A e dërgon Kuvendit a drejtorati.

Osman Sadikaj, realisht e dërgon kryetari.

Kryetari i komunës z. Haki Rugova – pasi që kjo qenka e ekzekutivit pse me u pyet kuvendi ktu, pse me shku në kuvend kjo pikë kotë.

Osmon Sadikaj – për ata unë edhe ndërhyra, ne me një shkresë drejtuar Ministres duhet dhëne pëlqimi nga ta dhe komuna ka te drejt ti ndaj këto mjete pastaj.

Enver Rugova , Drejtor i Shërbimeve Publike – Osmon këto mjete i ka nda Qeveria e Kosovës jau ka nda komunave, prape na me i pyetur ata.

Kryetari i Komunës z Haki Rugova – me i pyet po i pyesim por a duhet me marr vendim në Kuvend.

Osmon Sadikaj ZKF – jo tash duhet me i pyetur një herë pastaj me marr vendim. Vendimin e merr komisioni brenda komunës.

Kryetari i Komunës z Haki Rugova – ani atëherë pse e keni qitur këtë pikë këtu pasi qe janë tjera procedura.

Kuvendi komunal nuk lëshon pëlqime, Kuvendi komunal merr vendime.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, pasi që diskutime tjera nuk ka

Kush është qe kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës

Unanim hiqet nga rendi i ditës kjo pikë

Prezent të gjithë anëtarët e komitetit,

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon: që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë

<b>Shqyrtimi i kërkesës 08Nr.316/2020 të datës 02.11.2020 nga Drejtorati për Shërbime Publike, dhe mos ti shkoj KK për shqyrtim.</b>	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 9.</b>	
<p><b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b>, vazhdojmë më pikën e nënt të rendit të ditës , Shqyrtimi i dhe miratimi i Anulimit të Vendimeve me numër 01Nr-29/2019; 01Nr-30/2019; 01Nr-31/2019; 01Nr-32/2019; 01Nr-33/2019; të gjitha të marra me datën 29.03.2019, këto vendime duhet të anulohen për shkak se të njëjtat nuk kanë kaluar në ankand sipas një raporti nga drejtoria e Bujqësisë dhe të zyrtarit për prona. Prandaj propozoj që këto Vendime të anulohen.</p> <p>Ju lutem sekretarisë që materialin ta bëj kopje dhe tua sjell ju këtu të gjithë anëtareve.</p> <p>E kemi shkresën inicuese nga Bujqësia .</p> <p><b>Zenel Shatri</b> - Kryesues në si anëtar të KPF-së nuk kemi asgjë as një informatë apo dokument lidhur me këtë pikë.</p> <p><b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b>, Zenel në fillim të takimit jua lexova dhe që ku është.</p> <p><b>Zenel Shatri</b> - ne materialin nuk e kemi këtu përpara cilën pikë me eliminuar silli ti shohim vendimet ku janë vendimet.</p> <p><b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b>, e lemë nuk e qesim. Tani ju vijnë edhe kopjet unë në fillim të mbledhjes jua sqarova.</p> <p>Kjo pikë hiqet nga rendi i ditës.</p>	
<b>Diskutimet:</b>	
<b>Vendimet:</b>	
<b>Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon që : të hiqet kjo pikë e rendit të ditës, nuk kalohet në kuvend për shqyrtim.</b>	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Diskutime tjera:</b>	
<p><b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b>, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.</p> <p>Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.</p>	
<b>Mbledhja përfundoj :</b>	<b>11:40</b>

Procesmbajtëse,  
Znj. Vjosa Hysenaj


